

VENDIM
Nr. 276, datë 29.4.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.721, DATË 11.11.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E DOKUMENTACIONIT, SHUMËS VJETORE TË TRANSFERTËS NGA BUXHETI I SHTETIT DHE PROCEDURAVE TË FINANCIMIT TË FONDIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE PËR TRAJTIMIN FINANCIAR SUPLEMENTAR TË PUNONJËSVE QË KANË PUNUAR NË MINIERA NË NËNTOKË, TË PUNONJËSVE TË INDUSTRIKËS SË NAFTËS E TË GAZIT DHE TË PUNONJËSVE QË KANË PUNUAR NË METALURGJI"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 13, të ligjit nr.29/2019, "Për trajtimin financiar suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.721, datë 11.11.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Për të përfutur pension për shkak të profesionit, personat që plotësojnë kushtet sipas ligjit, plotësojnë kërkesën nëpërmjet portalit qeveritar "*e-Albania*" dhe dërgojnë nëpërmjet shërbimit postar pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore ku kanë vendbanimin, dokumentet shoqëruese, si më poshtë vijon:

- a) Librezën e punës të plotësuar në të gjitha rubrikat, sipas llojit të punës;
- b) Vërtetimin për bazën e vlerësuar për periudhat e punësimit nga data 1.1.1994 deri në datën e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare nga puna ose vetëpunësimi;
- c) Vërtetimin e posaçëm të konfirmimit të llojit të punës në profesionet e vështira, sipas përcaktimeve në këtë ligj dhe në vendimin nr.526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, "Për ndarjen e punëve në kategori, për efekt pensioni", i lëshuar nga ndërmarrja ku personi ka qenë i punësuar, kur subjekti është aktiv ose nga dokumentacioni arkivor i sigurimeve shoqërore;
- ç) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton llojin dhe periudhën e punës për efekt pensioni, i njohur për zbatimin e dispozitave të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar."

2. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Për të përfutur shtesë mbi pensionin, sipas nenit 4, të ligjit nr.29/2019, "Për trajtimin financiar suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji", personat që plotësojnë kushtet e neneve 3 e 6, të këtij ligji, dhe janë përfutues të pensionit sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966, "Mbi sigurimet shoqërore shtetërore të Republikës Popullore të Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të pensionit të parakohshëm, sipas nenit 96, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, të ndryshuar, si dhe sipas ligjit nr.150/2014, "Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë", kur data e lindjes të së drejtës për pension është deri më 31.12.2014, plotësojnë kërkesën nëpërmjet portalit qeveritar "*e-Albania*" dhe dërgojnë nëpërmjet shërbimit postar pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, ku kanë vendbanimin, çdo dokumentacion tjetër që vërteton llojin dhe periudhën e punës, për efekt pensioni, i njohur për zbatimin e dispozitave të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar."

II. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj